



DPR/DMP

03-970/2012

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

09.03.2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr. regj. 16949/10

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDRAVAJTJE NË PRISHTINË, Gjyqtarja Lindita Jakupime pjesmarrjen e sekretares juridike Iqrame Aliu, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Mehdi Polisi nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtareve të lartë Publik, e në bazë të nenit 73,74,195 dhe nenit 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 30.09.2011 merr këtë:

AKTVENDIM

I PANDEHURI: Mehdi Dilaver Polisi, i lindur më 1953 në Struge, tani jeton në Prishtinë ne Rr. Mati pn., profesor në Fakultetin Filologjike-Prodekan, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike,

Ë s h t ë p e r g j e g j e s

Sepse më 22.03.2010 si Prodekan dhe profesor në fakultetin Filologjik-Universiteti i Prishtinës, ka pranuar formularin për Deklarimin e Pasurisë dhe këtë formular nuk ja ka dërguar Agjencioni Antikorrupsion.

Me cka ka kryer kundërvajtje nga 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtareve të lartë Publik. Andaj per këtë

GJOBITET

Me gjobë në shumën prej 300 (treqind) €, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës kur ky aktvendim të marrë formë të prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore KGJK-se nr. 1000430070000518. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 20 ditësh, duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) €, për një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar që të paguaj shumën prej 5 € në afat dhe xhirrollogari të njëjtë me gjobën.

Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dorzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencioni Kunder Korrupsionit në Prishtinë, parashtror kërkesën nr. 01/2306/10 të dt.08.06.2010, për inicimin e procedurës kundërvajtëse kundër të lartëpërmendurit dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me Aktvendimin e dt. 19.08.2010 Gjykata për Kundërvajtje në Prishtinë ka shpallur fajtor të pandehurin Mehdi Polisin dhe ka dënuar me gjobe prej 1000 (njmijë) euro, konform dispozitivit ligjor të nenit 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtareve të lartë Publik.

Kunder këtij Aktvendimi pala e paknaqur brenda afatit ligjor ka parashtruar ankese me të cilën ka theksuar se Agjencioni Kunder Korrupsionit në Prishtinë nuk i ka dërguar formularin për plotsim mbi Deklarimin e Pasurisë dhe Dhuratave, si dhe denimi është shumë i lartë pasi që perhere të pare ka nuk e ka deklaruar pasurinë.

Me Aktvendimin e Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë nr. Gjl. nr.1142/2010 të dt. 21.10.2010, ka miratuar ankesën si të bazuar me të cilin dhe me këtë Vendim ceket se gjendja faktike nuk është vertetur në masë të plote. Me Verejtjen e Aktvendimit të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë nr. Gjl. nr.1142/2010 të dt. 21.10.2010 Gjykata për Kundërvajtje në Prishtinë ndryshoi Vendimin e dt. 19.08.2010 dhe vertetoi në masë të plote dhe të drejte gjendjen faktike duke e ftuar parshtruesin e kërkesës Enis Sadiku, Zyrtar i lartë në Agjencionin Kunder Korrupsionit në Prishtinë, i cili ka deklaroi se të pandehurit i kishin dërguar formularin për plotsim mbi Deklarimin e Pasurisë dhe Dhuratave, përmes pikes kontaktuese të Rektorit të Univeristetit me dt. 22.03.2010.

Në bazë të të dhënave të parashtruara në kërkesë, ndëgjimit të të pandehurit, deshmitarit-Zyrtarit të Agjencioni Kunder Korrupsionit, Aktvendimit të GJL nr. 1142/2010, shiqimit të shkresave të lëndës dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtari në masë të mjaftuar vertetoi se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në barrë, për çka e shpalli fajtor dhe e gjobiti me gjobën e cekur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimi të denimit, gjyqtari vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 të LMK-së, nën të cilat është kryer kundërvajtja dhe të pandehurit ia shqiptoi këtë lloj denimi, duke llogaritur se edhe me këtë do të arrihet efekti i sanksionimit, që i pandehuri në të ardhmen t'i shmanget kryerjes së veprave të këtilla dhe të ngjashme. Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrorjnjë ankesë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi, nëpërmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

Gjyqtari
Lindita Jakupi

